



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 par. 28 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit (MM) e lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe Komunës së Lipjanit nr. protokolit 1-510-41555 e datës 21.08.2015, Shkresën e Institutit Special në Shtime nr.155 e datës 11.04.2017 si dhe Procesverbalit të lëshuar nga Departamenti Qëndror i Shërbimeve Administrative –Divizioni i Administratës dhe Personelit nr.4865 i datës 29.10.2016, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

I. Me këtë Vendim, SISTEMOHEN- VENDOSËN në Shtëpinë Komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në Lipjan stafi punues i transferuar nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale përkatësisht Instituti Special në Shtime konform Marrëveshjes së Mirëkuptimit (MM) e lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale përfaqësuar nga Ministri i MPMS Arban Abrashi dhe Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari Imri Ahmeti.

II. OBLIGOHET, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Lipjan që për të punësuarit në tabelën në vijim të përgadisë kontratat e punës konform dispozitave të nenit 10 dhe 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.

Nr.	Emri dhe Mbiemri
1.	Arjeta Thaqi
2.	Shpejtim Gashi
3.	Mervete Nuredini
4.	Zejnije Tahiri
5.	Islam Tahiri

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen –Instituti Special në Shtime, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Lipjan dhe Shtëpia e Komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në Lipjan.

1Nr. 360-19689
Lipjan, më 18.04.2017

